



SHKÇAK - DKRRK - SCAAK PRISHTINË	
Nr. 109/25	Nr. i fletëve 11
Data 29/04/25	Nënshkrimi <i>[Signature]</i>

STATUTI I SHOQATËS SË KONTABILISTËVE TË ÇERTIFIKUAR DHE AUDITORËVE TË KOSOVËS (SHKÇAK) SOCIETY OF CERTIFIED ACCOUNTANTS AND AUDITORS OF KOSOVO (SCAAK)

Përmbajtja

Pjesa 1: Përkufizimet

Neni 1

Pjesa 2: Themelimi, Përfaqësimi dhe Qëllimi i Shoqatës

- Neni 2 - Emri, anëtarët themelues dhe data e regjistrimit
- Neni 3 - Adresa e regjistruar dhe faqja zyrtare elektronike e Shoqatës
- Neni 4 - Vula e Shoqatës
- Neni 5 - Statusi ligjor
- Neni 6 - Përfaqësuesi i autorizuar dhe përfaqësimi i Shoqatës
- Neni 7 - Komunikimi elektronik
- Neni 8 - Territori i fushëveprimit
- Neni 9 - Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës

Pjesa 3: Anëtarësia

- Neni 10 - Anëtarët e Shoqatës
- Neni 11 - Përfundimi i anëtarësisë
- Neni 12 - Suspendimi nga anëtarësia
- Neni 13 - Pasivizimi i anëtarësisë

Pjesa 4: Pjesëmarrësit tjerë në Shoqatë

- Neni 14 - Subjektet e asociuara
- Neni 15 - Anëtarët e nderit të Shoqatës
- Neni 16 - Tarifat e anëtarësimit dhe asocimit

Pjesa 5: Organet Udhëheqëse dhe Ekzekutive të Shoqatës

- Neni 17 - Kuvendi i Anëtarëve
- Neni 18 - Mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve
- Neni 19 - Rendi i ditës dhe çështje të posaçme në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve
- Neni 20 - Kuorumi
- Neni 21 - Votimi

Bordi i Shoqatës

- Neni 22 - Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Shoqatës
- Neni 23 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Shoqatës
- Neni 24 - Përfundimi I anëtarësisë në Bordin e Shoqatës
- Neni 25 - Kryetari dhe Nënkyetari i Bordit të Shoqatës
- Neni 26 – Pjesëmarrja në paraqitjet publike
- Neni 27 - Thesaristi
- Neni 28 - Mbledhjet e Bordit të Shoqatës
- Neni 29 - Votimi në Mbledhjet e Bordit të Shoqatës
- Neni 30 - Komisionet e Shoqatës
- Neni 31 - Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Shoqatës
- Neni 32 - Drejtori Ekzekutiv
- Neni 33 - Detyrat dhe përgjegjësitë
- Neni 34 - Komisioni për nominime

Pjesa 6: Procedurat disiplinore ndaj anëtarëve të Shoqatës

- Neni 35 - Përbërja e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë
- Neni 36 - Shkeljet disiplinore
- Neni 37 - Procedura Disiplinore
- Neni 38 - Masat disiplinore
- Neni 39 - E drejta në ankesë
- Neni 40 – Ankesat tjera

Pjesa 7: Rregullat e Mirësjelljes Profesionale

- Neni 41 – Rregullat e mirësjelljes profesionale

Pjesa 8: Pasuria e Shoqatës

- Neni 42 - Pasuritë

Pjesa 9: Shpërbërja e Shoqatës

- Neni 43 - Shpërbërja e Shoqatës dhe shpërndarja e pasurisë së saj

Pjesa 10 – Dispozitat kalimtare

- Neni 44 – Mandati i anëtarëve aktual të Bordit

Pjesa 11: Hyrja në fuqi

- Neni 45 - Hyrja në fuqi dhe ndryshimet e Statutit
- Neni 46 - Hyrja në fuqi e rregulloreve për të drejtat dhe obligimet e anëtarëve

Ky Statut është dokumenti themelor i Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut No. 1999/22 (në vijim "SHKÇAK" apo "Shoqata") dhe i harmonizuar me Ligjin Nr. 06/L-43 mbi Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

Pjesa 1.
Neni 1
Përkufizimet

Ligji i Aplikueshëm – i referohet dispozitave të Ligjit Nr.06/L-43 mbi Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe çdo plotësim/ndryshim i mëvonshëm të njëjtit si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në Kosovë.

ShKÇAK/Shoqata – Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

FNK – Federata Ndërkombëtare e Kontabilitetit

Kodi Etik – Kodi Profesional Etik të FNK

Anëtarët – Anëtarët e Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar të Auditorëve të Kosovës

Anëtar aktiv në Shoqatë - çdo anëtar i Shoqatës me të drejtë vote, i cili nuk është i suspenduar, apo të cilit nuk i është pezulluar apo pasivizuar anëtarësia në pajtim me dispozitat e Statutit.

Mandati i lejuar – i referohet zgjedhjes së anëtarëve të Bordit për jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme nga tre (3) vite.

DOA të FNK – Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Konflikti i interesit – nënkupton rrethanën në lidhje me të cilën anëtari /punonjësi i Shoqatës ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij/saj në cilësi të anëtarit / punonjësit

Prokurë – autorizimi i dhënë për deklarim të votës nga një anëtar te tjetri për çështjet nga mbledhja përkatëse e Kuvendit.

Fjalët e cilësdo gjini të përdorura në këtë Statut do të nënkuptojnë edhe gjininë tjetër dhe fjalët e përdorura në njëjës do të nënkuptojnë edhe shumësin dhe shumësi do të nënkuptojë edhe njëjësin, aty ku është e aplikueshme.

Pjesa 2.
THEMELIMI. PËRFAQËSIMI DHE QËLLIMI I SHOQATËS

Neni 2

Emri, anëtarët themelues dhe data e regjistrimit

- 2.1 Shoqata u regjistrua me 16 Maj 2001, me emërtimin "Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës". Anëtarët themelues të Shoqatës janë:

Jan Tyl, Voskovcova 1657, Cernosice 252 28, Czech Rep.
Lekë Musa, Ulpiana A/3 H-3 No.10, Prishtinë
Shukri Gashi, "Dukagjini" 6, Mitrovica
Bujar Sokoli, "Arbedin Terbeshi"- Arbëria, No.1, Prishtinë
Mustafe Ibrahim, "Bregu i Diellit" Rr. III, Lam. 11, Ban.14, Prishtinë
Lindita Shala, 3288 Reservoir Oval E Apt#504, Bronx, NY 10467 USA
Gina Kuta, 104 Wilson Street, Prishtinë
Bashkim Uka, Metohia Street No.8, Prishtinë
Tomorr Zhaveli, "Fan Noli" Arbëria, no. 23, Prishtinë
Faton Zeqiri, Rr "TMK"- Qafa, Lam. "C", Ban. 18, Prishtinë
Avni Jashari, Rr. "Sharrit" No. 10/a, Prishtinë
Gëzim Pirana, Rr. Adriatiku No.12, Prizren
Eugen Nuri, "Fehmi Agani"- Arbëria No.1, Prishtinë

Neni 3

Adresa e regjistruar dhe faqja zyrtare elektronike e Shoqatës

- 3.1 Selia e Shoqatës është në Prishtinë. Adresa e regjistruar e Shoqatës është edhe adresa e dorëzimit të dokumenteve ligjore për Shoqatën.
- 3.2 Ueb faqja e Shoqatës është faqja zyrtare elektronike.

Neni 4

Vula e Shoqatës

- 4.1 Vula e Shoqatës do të ketë formë të rrumbullakët, me diametër përafërsisht 4.5 cm, dhe do të ketë të gdhendur emërtimin Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (apo akronimin e saj) në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Neni 5

Statusi ligjor

- 5.1 Shoqata është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit të aplikueshëm.
- 5.2 Shoqata është person i pavarur juridik i cili mund të paditet dhe të padis në emër të vet.

Neni 6
Përfaqësuesi i autorizuar dhe përfaqësimi i Shoqatës

- 6.1 Përfaqësuesi i autorizuar i Shoqatës është Drejtori Ekzekutiv.
- 6.2 Në cilësi të personit të autorizuar, përfaqësuesi i Shoqatës do të jetë përgjegjës për përfaqësimin e Shoqatës, pranimin e të gjitha shkresave zyrtare të Shoqatës, informimin e autoriteteve kompetente për të gjitha ndryshimet në të dhënat e deklaruara, për hapjen dhe administrimin e llogarisë bankare, nënshkrimin e raporteve të Shoqatës dhe për saktësinë edhe vërtetësinë e të njëjtave si dhe autorizime dhe përgjegjësi tjera të caktuara me Ligj dhe nga ana e Kuvendit të Shoqatës.

Neni 7
Komunikimi elektronik

- 7.1 Të gjitha referencat në Statut lidhur me shpalljet ose komunikimet me shkrim do të përfshijnë komunikimet elektronike, përfshirë edhe e-mailin, faksin, shpalljet në ueb faqen e Shoqatës dhe mjetet e tjera të aprovuara nga ana e Bordit.

Neni 8
Territori i fushëveprimit

- 8.1 Shoqata do ushtrojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
- 8.2 Shoqata mund të hap degët e saj edhe jashtë territorit të Republikës Kosovës, por selia e Shoqatës mbetet adresa e regjistruar e saj pranë autoritetit të regjistrimit të Shoqatës.

Neni 9
Qëllimet, objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës

- 9.1 SHKÇAK synon të jetë shoqatë prijëse në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit.
- 9.2 Qëllimi i SHKÇAK është:
- (i) të avancojë interesin publik përmes arritjes dhe promovimit të standardeve më të larta profesionale si dhe ofrimin e ekselencës në lëmin e kontabilitetit, auditimit, qeverisjes dhe menaxhimit financiar në të gjithë sektorët ekonomik të Republikës së Kosovës;
 - (ii) të ofroj udhëheqje me integritet, objektivitet dhe me përkushtim ndaj cilësisë në profesion;
 - (iii) të veproj si qendër e ekselencës në kontabilitet, auditim dhe fushat relevante të profesionit;
 - (iv) të ofroj programe të edukimit, avancime profesionale, konsulenca profesionale për rritje të cilësisë të shërbimeve për anëtarët e saj dhe për palët e tjera të interesuara;
 - (v) të çertifikoj profesionistët në fushën e kontabilitetit dhe auditimit dhe fusha tjera të ndërlidhura;
 - (vi) të mbrojnë dhe ruaj pavarësinë profesionale dhe të ushtrojë mbikëqyrjen profesionale ndaj anëtarëve të saj;
 - (vii) të organizojë dhe mirëmbajë skema për dhënien e certifikatave dhe diplomave për personat që i plotësojnë kriteret për anëtarësim dhe për personat e organizatave tjera profesionale;
 - (viii) të promovojë dhe lehtësojë përhapjen dhe shkëmbimin e informatave tek anëtarët dhe palët e ndërlidhura për të gjitha çështjet me interes profesional përmes konferencave, punëtorive, seminareve dhe përmes publikimit të raporteve, analizave dhe studimeve që ndërlidhen me zhvillimet dhe risitë në profesion.

- (ix) të përcaktoj procesin e hetimit dhe disiplinës për anëtarët dhe studentët e saj përmes një organi të themeluar dhe të zhvilloj procesin e hetimit dhe disiplinës ndaj të gjithë atyre që mund të jenë subjekt i këtij procesi.
 - (x) të ofroj këshilla dhe ekspertizën e saj për çështje profesionale për institucionet relevante.
 - (xi) të ndërmerr të gjitha këto veprime dhe veprimet tjera në përputhje me këtë Statut si dhe akteve tjera normative të Shoqatës me qëllim të avancimit dhe mbrojtjes së interesave të Shoqatës dhe anëtarëve të saj.
- 9.3 SHKÇAK përfaqëson profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, dhe i udhëzon anëtarët e saj në përputhje me Kodin Etik të FNK, rregullat dhe parimet e mirësjelljes për anëtarët e saj, por duke mos u kufizuar vetëm në to.
- 9.4 Ky Statut e obligon ShKÇAK për:
- (i) implementimin e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK);
 - (ii) pjesëmarrjen në Programin e FNK për Përputhshmëri të Organizatave Anëtare; dhe
 - (iii) arritjen e përputhshmërisë së plotë me detyrimet aktuale dhe ato të ardhshme të publikuara nga FNK për anëtarët e saj.
- 9.5 SHKÇAK është anëtare dhe bashkëpunon me institucionet dhe shoqatat regjionale dhe ndërkombëtare profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, rregullatorët, standard-vënësit dhe organet përfaqësuese për kontabilist dhe auditorë.

Pjesa 3.
ANËTARËSIA

Neni 10
Anëtarët e Shoqatës

- 10.1 Anëtarët e Shoqatës përbëjnë Kuvendin e Anëtarëve të Shoqatës.
- 10.2 Anëtarë të Shoqatës, nën kushtet e përcaktuara me Statut, vendimet e Kuvendit të Anëtarëve dhe aktet tjera normative të Shoqatës mund të jenë :
- Auditor i certifikuar nga sektori privat apo publik
 - Kontabilist i certifikuar nga sektori privat apo publik
 - Auditor i brendshëm i certifikuar nga sektori privat apo publik
- 10.3 Për qëllime të anëtarësimit në Shoqatë, profesionistët e shënuar në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të kenë plotësuar këto kritere:
- (i) kanë kaluar provimet e parapara për të fituar thirrjen profesionale;
 - (ii) kanë përmbushur kërkesat e përvojës praktike të përcaktuara nga Bordi i Shoqatës apo ndonjë trup tjetër relevant rregullator dhe aprovuar nga Bordi i Shoqatës;
 - (iii) kanë nënshkruar deklaratën e pajtueshmërisë me obligimet profesionale të anëtarësisë së SHKÇAK;
 - (iv) kanë paguar tarifat adekuate të anëtarësisë të përcaktuara nga Kuvendi i Anëtarëve;
 - (v) kanë përmbushur çfarëdo kërkesë tjetër profesionale të caktuar nga Bordi i Shoqatës kohë pas kohe;
 - (vi) nuk është i anëtarësuar në ndonjë Shoqatë tjetër profesionale të njëjtë/ngjashme në Republikën e Kosovës.
- 10.4 Aplikacioni për t'u bërë anëtar do të aprovohet nga SHKÇAK vetëm nëse të gjitha kushtet për anëtarësim janë përmbushur dhe aplikuesi nuk është i diskualifikuar për t'u bërë anëtar.
- 10.5 Çdo anëtar i Shoqatës i pranuar në Shoqatë sipas kërkesave të këtij neni është anëtar i Shoqatës me të drejtë vote dhe është i obliguar që të deklarojë votën lidhur me çështjet për të cilat thirret Kuvendi i Anëtarëve qoftë duke votuar për, kundër apo duke abstenuar nga votimi.
- 10.6 Bordi i Shoqatës mundet kohë pas kohe ti propozoj Kuvendit të Anëtarëve për miratim thirrje tjera profesionale për qëllime anëtarësimi në Shoqatë.

Neni 11

Përfundimi i anëtarësisë

- 11.1 Anëtari i Shoqatës do të largohet nga Shoqata, respektivisht do t'i përfundojë anëtarësia në rast të:
- (i) Dorëheqjes;
 - (ii) Humbjes së aftësisë së veprimit;
 - (iii) Shpalljes fajtor për vepër penale në lidhje me ushtrimin e profesionit;
 - (iv) Rrezikimit të interesave të Shoqatës duke vepruar në kundërshtim me vendimet e Kuvendit të Anëtarëve;
 - (v) Shkeljes së rregullave të Kodit të Etikës dhe detyrimeve tjera të anëtarit të cilat burojnë nga Statuti, aktet tjera normative të Shoqatës dhe Vendimet detyruese të organeve të Shoqatës;
 - (vi) Mospagesës së anëtarësisë apo detyrimeve tjera financiare ndaj Shoqatës, nën kushtet e përcaktuara me dispozitat e Statutit dhe akteve normative;
 - (vii) Mosdeklarimi i votës për, kundër apo abstenim lidhur me çështjet për të cilat është thirr mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve, qoftë përmes pjesëmarrjes fizike në mbledhjen e Kuvendit apo përmes deklarimit të votës me shkrim, votimit elektronik apo përmes prokurës.
- 11.2 Në lidhje me arsyet e përfundimit të anëtarësisë sipas pikave (iv), (v) të nenit 11.1. ndaj anëtarit të Shoqatës do të zhvillohet procedurë disiplinore, kurse për arsyet nga pikat tjera të nenit 11.1. përfundimi i anëtarësisë ndodh automatikisht, sipas njoftimit të bërë nga Zyra ekzekutive, apo nga Kryesia e Mbledhjes së Kuvendit të Anëtarëve lidhur me pikën (vii) të nenit 11.1., posa të vërtetohet ekzistimi i rrethanës përkatëse për përfundimin e anëtarësisë së anëtarit.
- 11.3 Anëtari i larguar nga Shoqata mund të ri-anëtarësohet në Shoqatë para skadimit të afatit prej një (1) viti nga largimi dhe pa plotësuar kriteret e ri-anëtarësimit të përcaktuara me aktet normative të Shoqatës.
- Anëtari i larguar nga Shoqata për shkak të mos-votimit në mbledhje të Kuvendit të Anëtarëve mund të ri-anëtarësohen brenda periudhës 3 muajore prej përfundimit të anëtarësisë apo brenda një afati më të shkurtë kohor, nëse dëshmon se nuk ka ushtruar obligimin e votimit për shkak të ndonjë pengese që nuk ka mund të parashikohet dhe as të evitohet nga ana e tij/saj.
- 11.4 Përgjashtimisht, anëtarit të cilit i përfundon anëtarësia sipas pikave (i) deri (v) nuk e ka të drejtën e ri-anëtarësimit në Shoqatë.
- 11.5 Me vdekjen e anëtarit të Shoqatës anëtarësia në Shoqatë përfundon automatikisht.

Neni 12

Suspendimi nga anëtarësia

- 12.1 Anëtarët e Shoqatës ndaj të cilëve zhvillohet procedura disiplinore për arsyet e përfundimit të anëtarësisë sipas pikave (iv), (v) të nenit 11.1 të Statutit suspendohen nga anëtarësia në Shoqatë deri në vendim përfundimtar të organit disiplinor.

Neni 13

Pasivizimi i anëtarësisë

- 13.1 Anëtarët kanë të drejtë të kërkojnë pasivizim të anëtarësisë për periudhë jo më të shkurtër se një (1) vit nëse:
- Vuajnë nga ndonjë sëmundje e cila i pamundëson ushtrimin e profesionit, apo
 - Dëshmojnë se përkohësisht kanë pushuar ushtrimin e profesionit;
- 13.2 Kërkesa për pasivizim do të aprovohet vetëm pas vërtetimit se janë përmbush të gjitha obligimet financiare deri në momentin e paraqitjes së kërkesës. Të drejtat dhe detyrimet, kompetencat për aprovimin e kërkesës për pasivizim dhe kërkesat për ri-anëtarësim përcaktohen me Rregulloren mbi obligimet e anëtarëve dhe subjekteve të asocuara.

Pjesa 4.
PJESËMARRËSIT TJERË NË SHOQATË

Neni 14

Subjektet e asociuara

- 14.1 Për qëllime të përmbushjes së misionit të Shoqatës, në cilësi të subjekteve të asociuara mund t'i bashkëngjiten edhe persona tjerë fizik dhe juridik të cilët e përkrahin misionin e SHKÇAK, plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Bordi i Shoqatës dhe pranojnë obligimet që rrjedhin nga dispozitat relevante të Statutit të SHKÇAK.
- 14.2 Subjektet e asociuara në Shoqatë do të kenë qasje në avancimet profesionale të cilat ofrohen nga Shoqata, por nuk kanë të drejtë vote në Shoqatë dhe nuk marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve.
- 14.3 Bordi i Shoqatës do të përcaktojë me akte normative kriteret të cilat duhet t'i përmbush një person për tu bërë apo për të mbetur subjekt i asociuar në Shoqatë.
- 14.4 Subjektet e asociuara do të paguajnë tarifë vjetore të asociimit sipas vendimit të Bordit të Shoqatës dhe do të pajisen me certifikatën përkatëse të asociimit në Shoqatë sipas kriterëve të nxjerra nga Bordi i Shoqatës.
- 14.5 Subjektet e asociuara mund të largohen nga Shoqata me vendim të Bordit të Shoqatës, për shkak të mospagesës së tarifës vjetore dhe për arsye të specifikuara në nenin 11, me përjashtim të arsyes së mospjesëmarrjes në Mbledhjet e Shoqatës, sipas pikës vii) të nenit 11.1.

Neni 15

Anëtarët e nderit të Shoqatës

- 15.1 Anëtar i nderit i Shoqatës është ai individ i cili me punën e tij të shkëlqyeshme dhe të shquar i ka kontribuar Shoqatës në përmbushjen e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve.
- 15.2 Bordi i Shoqatës do të rekomandojë nominimin e individit apo individëve të cilët i plotësojnë kriteret për Anëtar nderi. Këto nominime do të aprovohen nga Kuvendi i Anëtarëve .
- 15.3 Anëtarët e nderit nuk do të kenë të drejtë që të marrin pjesë aktivisht në punën e Shoqatës. Anëtarësimi i tyre do të jetë vetëm çështje prestigji dhe ata nuk do të jenë të obliguar të paguajnë anëtarësi.
- 15.4 Anëtarët themelues të cilët nuk i plotësojnë kriteret për anëtarësim do të konsiderohen Anëtar nderi të Shoqatës.

Neni 16

Tarifa e anëtarësisë

- 16.1 Kuvendi i Anëtarëve do të vendosë në lidhje me strukturën e tarifës për anëtarësi në Shoqatë, duke u bazuar në rekomandimet e Bordit të Shoqatës.
- 16.2 PAGESA për anëtarësi dhe asociim në Shoqatë do të jetë pagesë për vit kalendarik dhe me rregull paguhet deri më datë 31 janar për vitin përkatës. Nëse kjo tarifë vjetore nuk paguhet brenda këtij afati, anëtarit/anëtarëve do t'u pezullohet anëtarësia, nuk ftohen për pjesëmarrje dhe votim në Mbledhjen e Kuvendit dhe nuk mund të marrin pozita në organet e Shoqatës.
Pezullimi i anëtarësisë do të vlejë deri me datë 01 mars brenda së cilës periudhë anëtarët mund t'i kryejnë obligimin e anëtarësisë vjetore. Anëtarëve të cilët nuk e kanë përmbushur këtë obligim deri me 01 mars të vitit u përfundon anëtarësia me automatizëm dhe do të largohen nga listat publike. Zyra Ekzekutive obligohet që t'i njoftoj anëtarët për afatet e pagesës së anëtarësisë dhe obligimeve tjera financiare, më së largu me 01 dhjetor të vitit përkatës.
- 16.3 PAGESA e anëtarësisë vjetore do të konsiderohet e realizuar vetëm kur janë të përmbushura të gjitha obligimet e tjera financiare ndaj Shoqatës.

Pjesa 5.
ORGANET UDHËHEQËSE DHE EKZEKUTIVE TË SHOQATËS

Neni 17
Kuvendi i Anëtarëve

Përbërja, të drejtat dhe përgjegjësitë

- 17.1 Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqatës i përbërë nga të gjithë anëtarët me të drejtë vote.
- 17.2. Listat e anëtarëve të Shoqatës janë publike dhe përditësohen nga Zyra ekzekutive.
- 17.3 Kuvendi i Anëtarëve do të:
- (i) aprovoj raportin vjetor të SHKÇAK të përgatitur në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjeve në fuqi përfshirë edhe pasqyrat e audituara financiare;
 - (ii) aprovoj buxhetin e ShKÇAK;
 - (iii) aprovoj amendamentet në Statutin e SHKÇAK;
 - (iv) aprovoj strategjinë e përgjithshme dhe propozimet e politikave të Bordit të Shoqatës të SHKÇAK;
 - (v) zgjedh anëtarët e Bordit të Shoqatës të SHKÇAK;
 - (vi) aprovoj tarifën vjetore për anëtarësi në SHKÇAK;
 - (vii) zgjedh auditorin për auditimin e pasqyrave financiare të ShKÇAK;
 - (viii) zgjedh anëtarët e Komisionit Disiplinor;
 - (ix) zgjedh anëtarët e Komisionit për Nominime;
 - (x) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Bordit;
 - (xi) aprovon hapjen e degëve jashtë vendit;
 - (xii) aprovon ri-organizimin e Shoqatës;
 - (xiii) merr vendime tjera sipas propozimit të Bordit të Shoqatës

Neni 18
Mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve

- 18.1 Kuvendi i Anëtarëve mbledhet së paku një herë në vit. Mbledhja e Përgjithshme e Kuvendit të Anëtarëve mbahet jo më vonë se deri më 30 mars të vitit, përveç kur përcaktohet ndryshe nga Bordi i Shoqatës.
- 18.2 Kryetari i Bordit do t'i njoftojë anëtarët për datën, vendin dhe kohën e Mbledhjes së Përgjithshme të rregullt së paku 15 ditë para ditës së takimit.
- 18.3 Në mbledhjet e rregullta Kuvendi i Anëtarëve do të vendosë në lidhje me çështjet e caktuara në nenin 17.3 të këtij Statuti.
- 18.4 Të gjitha çështjet tjera që nuk janë të caktuara në nenin 17.3 të këtij Statuti do të konsiderohen çështje të veçanta për të cilat mund të thirren mbledhje të jashtëzakonshme.
- 18.5 Pjesëmarrja në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve është obligative.
- 18.6 Anëtarët e Shoqatës që për arsye objektive, të dëshmuara, nuk mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Kuvendit u mundësohet votimi elektronik që do hapet 24 orë para mbajtjes së mbledhjes dhe do të mbyllet pas përfundimit të diskutimeve në Mbledhjen e Kuvendit.

- 18.7 Anëtarët e Kuvendit në pamundësi për të votuar përmes prezencës fizike apo sipas nenit 18.6 votën mund ta japin edhe përmes prokurës së dhënë një anëtar tjetër të Kuvendit. Prokura për votim deponohet me shkrim tek Kryesia e mbledhjes para votimit të pikave nga rendi i ditës.
- 18.8 Çështjet nga rendi i ditës në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve do të konsiderohen të votuara nëse për to janë deklaruar më shumë se gjysma e anëtarëve të Shoqatës, në cilëndo nga mënyrat e përcaktuara me dispozitat e këtij neni.
- 18.9 Me kërkesën e një të tretës të anëtarëve të Shoqatës, apo dy të tretave të anëtarëve të Bordit të Shoqatës, Kryetar i Bordit të Shoqatës thërret Mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve. Poqëse Kryetari i Bordit nuk organizon Mbledhjen e jashtëzakonshme në afatin prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, kërkuesit sipas këtij paragrafi mund ta thërrasin mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve në mënyrë të pavarur, kurse Drejtori Ekzekutiv do t'i marrë përsipër të gjitha funksionet e Kryetarit të Bordit për organizimin dhe udhëheqjen e mbledhjes në përputhje me dispozitat e këtij neni. Të gjitha dispozitat e Statutit lidhur me pjesëmarrjen, kuorumin, votimin në mbledhje të Kuvendit të Anëtarëve, vlejnë edhe për Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 19

Rendi i ditës dhe çështje të posaçme në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve

- 19.1 Së paku 15 ditë para mbajtjes së Mbledhjes së Kuvendit të Anëtarëve, anëtarët do të marrin:
- (i) njoftimin mbi kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së Mbledhjes;
 - (ii) rendin e ditës të detajuar të çështjeve që do të diskutohen në Mbledhje;
 - (iii) materialet e Mbledhjes
 - (iv) fletëvotimet dhe fletëvotimet e autorizuar në rast se anëtar i nuk mund të marrë pjesë.
- 19.2 Pas pranimit të materialeve për Mbledhje të Kuvendit anëtarët mund të dërgojnë komentet në afat prej 5 ditësh. Pas pranimit të komenteve Bordin, brenda 5 ditëve, do të shqyrtojë komentet e pranuar dhe do të dërgojë përgjigjet në komente dhe /apo materialin e rishikuar, të ndryshuar apo të plotësuar së paku 5 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
- 19.3 Anëtarët do të mund të propozojnë çështje për tu përfshirë në rendin e ditës si çështje të posaçme, të paraqesin komente apo ndryshime të tij të cilat do të pranohen nga Zyra Ekzekutive më së voni 7 ditë para mbajtjes së Mbledhjes. Propozimet për përfshirje në rendin e ditës, komentet dhe ndryshimet e pranuar pas këtij afati nuk do të përfshihen në diskutime nga Kuvendi në ditën e Mbledhjes së Kuvendit, si çështje të posaçme.
- 19.4 Bordin i Shoqatës në afat prej 4 ditëve pas pranimit të komenteve sipas paragrafit 19.2. do t'i shqyrtojë komentet e dërguara nga anëtarët dhe të marrë vendim mbi prezantimin e tyre në mbledhje.

Neni 20

Kuorumi

- 20.1 Kuorumi në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve arrihet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve aktiv të Shoqatës. Për ekzistimin e kuorunit llogariten edhe votat e dorëzuara përmes komunikimit elektronik dhe votimi me prokurë, në mënyrën e përcaktuar me nenin 18 të Statutit.
- 20.2 Nëse një anëtar i Kuvendit nuk merr pjesë në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve dhe nuk ka dërguar votën e tij/sa në formë elektronike apo nuk ka dhënë prokurën për votim sipas dispozitave të nenit 18.6 dhe 18.7. të Statutit duke deklaruar votën e tij/saj për, kundër apo abstenim do të konsiderohet se është larguar nga anëtarësia dhe anëtarësia do t'i përfundojë automatikisht, përpos nëse ka njoftuar Kuvendin e Anëtarëve për arsyet e mospjesëmarrjes nga neni 18.6. apo anëtarët tjerë të Kuvendit janë vënë në dijeni për pamundësi të pjesëmarrjes së anëtarit në mbledhje, për shkak të sëmundjes së rëndë, udhëtim jashtë vendit apo rastit të vdekjes në familje.

- 20.3 Në rrethanat nga paragrafi 2 i këtij neni Kryetari i Bordit do të konstatojë përfundimin e anëtarësisë së anëtarit/anëtarëve para fillimit të votimit në Mbledhje. Për qëllime të konstatimit të kuorumit për Mbledhje të Kuvendit, do të vazhdohet me numrin e anëtarëve prezent dhe atyre që kanë votuar përmes komunikimit elektronik apo votimit me prokurë.
- 20.4 Paragrafi 2 i këtij neni nuk zbatohet ndaj anëtarit të Shoqatës nëse anëtari ka njoftuar Kuvendin e Anëtarëve apo anëtarët tjerë të Kuvendit janë vënë në dijeni për pamundësi të pjesëmarrjes së anëtarit në mbledhje, për shkak të sëmundjes së rëndë, udhëtim jashtë vendit apo rastit të vdekjes në familje.
- 20.5 Në ditën e mbledhjes, kryesuesi do ta emërojë komisionin ad-hoc zgjedhor me detyrë për t'i numëruar votat me ngritje të dorës, me fletëvotime, përmes votimit elektronik apo përmes prokurës.
- 20.6 Kandidatët e nominuar për zgjedhje në Kuvend nuk mund të jenë anëtar të komisionit zgjedhor i cili do të numërojë votat.

Neni 21 Votimi

- 21.1 Vendimet e Kuvendit të Anëtarëve, përveç vendimit lidhur me shpërbërjen e Shoqatës, që do të merren në Mbledhjen e Përgjithshme apo të Jashtëzakonshme do të aprovohen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezent që bëjnë kuorumin, përpos nëse kërkohet ndryshe nga ky Statut.
- 21.2 Kuvendi i Anëtarëve do të vendosë me dy të tretat e votave të anëtarëve të Shoqatës për shpërbërjen e Shoqatës.

Bordi i Shoqatës

Neni 22 Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Shoqatës

- 22.1 Bordi i Shoqatës është organ i zgjedhur nga Kuvendi i Anëtarëve të cilit i janë deleguar autorizimet për organizimin dhe mbikëqyrjen e qeverisjes së SHKÇAK. Anëtarët e Bordit të Shoqatës zgjedhën dhe shkarkohen nga Kuvendi i Anëtarëve.
- 22.2 Bordi i Shoqatës do të ketë shtatë (7) anëtarë me këtë përbërje, Kryetari, Nënkryetari, Thesaristi dhe katër (4) anëtarë nga kategoritë e anëtarëve sipas nenit 10 të këtij Statuti.
- 22.3 Bordi i Shoqatës brenda viti kalendarik do të mbajë së paku katër (4) mbledhje.
- 22.4 Çdo anëtar i Shoqatës mund të jetë i përshtatshëm për tu zgjedhur (përfshirë rizgjedhjen) si anëtar i Bordit të Shoqatës nëse në datën e nominimit për zgjedhje apo njoftimit me shkrim për ri-zgjedhje, anëtari i plotëson kushtet për zgjedhje apo ri-zgjedhje bazuar në kriteret e përcaktuara nga SHKÇAK.
- 22.5 Anëtari mund të nominohet nga tre apo më shumë anëtarë të Shoqatës. Çdo nominim duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga secili anëtar që e ka bërë nominimin.
- 22.6 Anëtari i Bordit të Shoqatës i cili synon rizgjedhjen gjithashtu duhet të nominohet nga së paku tre apo më shumë anëtarë dhe duhet ta njoftojë me shkrim Bordin e Shoqatës për synimin e tij për rizgjedhje.
- 22.7 Çdo kandidat i cili synon zgjedhjen apo rizgjedhjen do ta nënshkruajë deklaratën me të cilën e konfirmon vullnetin e tij të jetë anëtar i Bordit të Shoqatës dhe se kandidati do të pajtohet me Kodin Profesional të Mirësjelljes të Shoqatës, aktet normative të Shoqatës, vendimet e miratuara nga organet udhëheqëse të Shoqatës.

- 22.8 Anëtarët e Bordit të Shoqatës duhet të jenë profesionalisht aktiv në sektorin privat apo publik të kontabilitetit, auditimit, bankave, financave, sigurimeve apo sektori tjetër të tregtisë.
- 22.9 Bordi i Shoqatës do të udhëhiqet nga Kryetari i Bordit.
- 22.10 Anëtarët e Bordit të Shoqatës do të zgjedhën vetëm për mandatin e lejuar.
- 22.11 Në përbërjen e Bordit nuk mund të zgjedhën dy (2) apo më tepër anëtarë nga e njëjta organizatë/institucion.
- Në raste të tilla, kur dy (2) apo më tepër anëtarë nga e njëjta organizatë/institucion kanë fituar numër të mjaftueshëm të votave për anëtarë të Bordit, do të zgjedhet ai që ka fituar më shumë vota kurse anëtari tjetër do të zëvendësohet me anëtarin me numrin më të madh të votave me radhë nga e njëjta kategori si të përcaktuara me nenin 10.2 të Statutit.
- 22.12 Në rastet kur dy apo më tepër anëtarë kanë numër të njëjtë të votave do përsëritet votimi dhe anëtari me më shumë vota të fituara nga anëtarët e pranishëm gjatë votimit të përsëritur do të zgjedhet anëtar i Bordit.
- 22.13 Në rastet kur gjatë procesit të nominimit nuk ka nominime për ndonjërin prej kategorive sipas nenit 10.2 të Statutit, pozita e anëtarit të Bordit nga ajo kategori plotësohet me anëtarin që ka fituar numrin më të madh të votave pavarësisht nga cila kategori.
- 22.14 Anëtari/Anëtarët që ri-zgjedhen në mandatin e dytë të njëpasnjëshëm nuk mund të kandidojnë dhe të zgjedhën për pozitën e Nënkryetarit të Bordit.
- 22.15 Anëtari i cili ka shërbyer si anëtar i Bordit të Shoqatës në mandatin e lejuar do të mund të kandidohet sërish pas kalimit të afatit trevjeçar në pajtim me paragrafin 22.4, 22.5 dhe 22.6 të këtij neni.
- 22.16 Kur një anëtar i Bordit të Shoqatës jep dorëheqje, shkarkohet nga Kuvendi i Anëtarëve apo vdes, ai/ajo do të zëvendësohet për mandatin e mbetur nga anëtari i cili në Mbledhjen e fundit të Kuvendit të Anëtarëve numër më të madh të votave me radhë për Bordi të Shoqatës nga e njëjta kategori apo sipas paragrafit 13 të këtij neni nëse zgjidhja e parë nuk është e aplikueshme.

Neni 23

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Shoqatës

- 23.1. Bordi i Shoqatës, në kuadër të detyrave të veta, do të ketë edhe këto të drejta dhe përgjegjësi specifike:
- (i) i propozon Kuvendit të Anëtarëve amendamentet dhe ndryshimet e Statutit të Shoqatës;
 - (ii) nxjerr rregulloret, akte tjera normative dhe vendime në suaza të autorizimeve të veta, duke përfshirë por pa u kufizuar në implementimin e DOA të FNK, për fushëveprimin e Shoqatës dhe Komisioneve;
 - (iii) interpreton Statutin e SHKÇAK;
 - (iv) i propozon Kuvendit të Anëtarëve strukturën e tarifës për anëtarësi vjetore;
 - (v) i prezanton Kuvendit të Anëtarëve pasqyrat financiare të audituara dhe raportin vjetor të punës;
 - (vi) zgjedh nënkryetarin e Bordit të Shoqatës dhe thesaristin (arkëtarin) e Bordit të Shoqatës nga radhët e veta;
 - (vii) themelon komisionet të cilat do të këshillojnë, udhëzojnë dhe implementojnë Qëllimet, Objektivat dhe Aktivitetet e SHKÇAK dhe dispozitat e këtij Statuti;
 - (viii) zgjedh dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv / Përfaqësuesin e autorizuar të Shoqatës;
 - (ix) i propozon Kuvendit Kryetarin e Bordit të Shoqatës;
 - (x) aprovon hapjen/mbylljen e llogarisë bankare.
- 23.2 Procedurat e punës së Bordit të Shoqatës përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 24
Përfundimi i anëtarësisë në Bordin e Shoqatës

- 24.1 Asnjë person nuk do të zgjedhet si anëtar i Bordit të Shoqatës, e poashtu dhe anëtarët e Bordit të Shoqatës të zgjedhur me herët do të shkarkohet për shkaqet për të cilat përfundohet anëtarësia në Shoqatë, sipas nenit 11 të Statutit dhe për arsyt tjera me sa vijojnë:
- (i) nuk është anëtar aktiv;
 - (ii) të qenit në gjini gjaku në vijë të drejtë në cilëndo shkallë dhe në vijë të tërthortë dhe gjini krushqie deri në shkallë të dytë me cilindo punonjës të Shoqatës;
 - (iii) mungesa pa ndonjë arsye të mirëfilltë, në tri e më tepër mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit të Shoqatës;
 - (iv) rrezikimi i interesave materiale të Shoqatës përmes punës dhe veprimeve të kryer;
 - (v) në rast të mos-shpalosjes tek anëtarët e Bordit të Shoqatës të rrethanave të konfliktit të interesit
- 24.2 Një anëtar i Bordit të Shoqatës i cili për çfarëdo arsye nuk mund të marrë pjesë në punën e Bordit të Shoqatës në një periudhë kohore prej gjashtë muaj automatikisht do të përfundojë pozita e tij/saj si anëtar Bordi të Shoqatës dhe në vend të tij/saj do të caktohet anëtari i Bordit të Shoqatës në pajtueshmëri me nenin 22.16 të Statutit.

Neni 25
Kryetari dhe Nënkyetari i Bordit të Shoqatës

- 25.1 Kryetari dhe Nënkyetari i Bordit të Shoqatës zgjedhën nga radhët e anëtarëve të Bordit të Shoqatës.
- 25.2 Mandati i Kryetarit dhe Nënkyetarit është trevjeçar pa të drejtë të rizgjedhjes në të njëjtën pozitë. Pas përfundimit të mandatit të Kryetarit, Nënkyetari i propozohet Kuvendit të anëtarëve për votim për pozitën e Kryetarit me mandat trevjeçar.
- 25.3 Kryetari dhe Nënkyetari gjatë anëtarësisë në Shoqatë nuk mund të zgjedhën më shumë se dy (2) herë në të njëjtën pozitë.
- 25.4 Kryetari ka këto kompetenca specifike:
- (i) thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve;
 - (ii) udhëheq mbledhjet e Bordit të Shoqatës ;
 - (iii) nënshkruan vendimet e Bordit dhe të Kuvendit kurse në mungesë të tij/saj i nënshkruan Nënkyetari;
 - (iv) merr pjesë së bashku me Drejtorin Ekzekutiv në paraqitjet publike të Shoqatës;
 - (v) dorëzon raportin vjetor për menaxhimin e pasurisë dhe aktivitetet e Shoqatës për Kuvendin e anëtarëve;
 - (vi) i merr përsipër të gjitha detyrat e tjera për përmbushjen e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve të Shoqatës.
- 25.5 Nënkyetari i Bordit asiston Kryetarin e Bordit në kryerjen e obligimeve të përcaktuar me paragrafin 4 të këtij neni. Në rast mungese të Kryetarit, Nënkyetari kryen obligimet e përcaktuara për Kryetarin e Bordit.

Neni 26
Pjesëmarrja në paraqitjet Publike

- 26.1 Pjesëmarrja në paraqitjet publike të Shoqatës, qoftë në vend apo ndërkombëtarisht, në media, forume dhe konferenca do të realizohen përmes Kryetarit të Bordit dhe/ ose Drejtorit Ekzekutiv. Në mungesë të Kryetarit, do të marrë pjesë Nënkryetari, dhe në mungesë të Drejtorit Ekzekutiv i deleguari i tij/saj.

Neni 27
Thesaristi (Arkatar)

- 27.1 Thesaristi (arkëtar) i Shoqatës është i zgjedhur nga Bordi i Shoqatës.
- 27.2. Thesaristi (arkëtar) ka përgjegjësitë si vijon:
- (i) Rishikon buxhetin vjetor dhe pasqyrat financiare të përgatitura nga Zyra Ekzekutive dhe ofron në Bord të Shoqatës, raporte të menaxhimit mbi çështjet financiare të Shoqatës;
 - (ii) Bashkëpunon me Zyrën Ekzekutive të Shoqatës dhe me auditorët e caktuar për të ndihmuar kryerjen në kohë të auditimit vjetor të pasqyrave financiare të Shoqatës dhe implementimin e rekomandimeve të dhëna pas kryerjes së auditimit.

Neni 28
Mbledhjet e Bordit të Shoqatës

- 28.1 Bordi i Shoqatës do të takohet së paku katër herë në vit. Mbledhjet e Bordit të Shoqatës do të thirren nga Kryetari i Bordit.
- 28.2 Anëtarët e Bordit të Shoqatës do të njoftohen së paku pesë ditë kalendarike para datës së mbledhjes së bashku me rendin e ditës, kohën dhe vendin e mbledhjes. Bordi i Shoqatës do të vendos për të gjitha çështjet të cekura me nenin 23 të këtij Statuti si dhe për çështjet tjera për mbështetjen e Qëllimeve, Objektiveve dhe Aktiviteteve.
- 28.3 Drejtori Ekzekutiv apo i deleguarin i tij/saj do të veproj si sekretar i mbledhjeve të Bordit të Shoqatës, do ta mbaj procesverbalin e çdo mbledhje dhe do t'ua shpërndaj anëtarëve të Bordit të Shoqatës për aprovim.
- 28.4 Anëtarë i Bordit të Shoqatës nuk do të marr pjesë në shqyrtimin e vendimeve për çfarëdo çështje në të cilat ka konflikt interesi.

Neni 29
Votimi në Mbledhjet e Bordit të Shoqatës

- 29.1 Bordi i Shoqatës do të vendosë për të gjitha çështjet me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve përpos nëse ceket ndryshe në Statut.
- 29.2 Në rast të votave të barabarta, Kryetari ka votën vendimtare.

Neni 30
Komisionet e Shoqatës

- 30.1 Bordi i Shoqatës do të themelojë komisione të Shoqatës të cilat do të këshillojnë, udhëzojnë dhe implementojnë Qëllimet, Objektivat dhe Aktivitetet e ShKÇAK, me përjashtim të Komisionit për nominime dhe Komisionit për sjellje dhe disiplinë që është në kompetencë të Kuvendit të Anëtarëve, si lidhur me themelimin, ashtu edhe lidhur me shpërndarjen dhe emërimin e anëtarëve të Komisionit.

- 30.2 Përbërja e secilit komision do të përcaktohet nga Bordi i Shoqatës. Anëtarët e komisioneve do të caktohen në rast se i përmbushin kërkesat e ftesës për nominime të publikuara nga Komisioni për Nominime për komisionin përkatës.
- 30.3 Në përbërjen e Komisionit nuk mund të caktohen më shumë se një anëtar nga e njëjta organizatë/institucion. Kryesuesit e Komisioneve të Shoqatës nuk mund të caktohen nga e njëjta organizatë/ institucion.
- 30.4 Bordi i Shoqatës mundet sipas kërkesës së kryetarit të komisionit të inkuadroj në komisione persona të cilët nuk janë anëtarë të ShKÇAK por të cilët posedojnë kualifikim dhe përvojë e cila kërkohet për realizimin efektiv të detyrave të komisionit. Anëtarët e ShKÇAK gjithmonë do të përbëjnë shumicën në komisione.
- 30.5 Përshkrimi i kërkesave për anëtarët e jashtëm të komisioneve do të përcaktohen nga kryetari i komisionit në konsultim me Komisionin për Nominime i cili do të publikojë ftesën për nominime.
- 30.6 Bordi i Shoqatës do të përcaktoj me rregullore apo akte tjera normative përbërjen, funksionimin, procedurat e punës detyrat dhe përgjegjësitë dhe mënyrën e vendosjes të secilit Komision.
- 30.7 Bordi i Shoqatës mund ta shpërndaj çdo komision në tërësi apo një pjesë të tij.

Neni 31 **Angazhimi vullnetar i Bordit të** **Shoqatës**

- 31.1 Anëtarët e Bordit të Shoqatës janë të angazhuar në Shoqatë në baza vullnetare dhe do të kompensohen për shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhje në pajtim me buxhetin vjetor të Shoqatës.

Neni 32 **Zyra Ekzekutive e Shoqatës** **Drejtori Ekzekutiv**

- 32.1 Drejtori Ekzekutiv zgjedhet nga Bordi i Shoqatës. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv është katër (4) vite me mundësi rizgjedhje.
- 32.2 Drejtori Ekzekutiv do t'i raportojë Kryetarit të Bordit dhe Bordit të Shoqatës.

Neni 33 **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- 33.1 Drejtori Ekzekutiv në kuadër të detyrave të veta i ka edhe këto përgjegjësi specifike:
- (i) të punojë me Bordin e Shoqatës në zhvillimin dhe implementimin e biznes planit strategjik afatgjatë si dhe planit vjetor të Shoqatës;
 - (ii) të ndërtojë kapacitete organizative të Shoqatës siç përcaktohet nga Bordi i Shoqatës .
 - (iii) të mbikëqyrë personelin e Zyrës Ekzekutive;
 - (iv) të organizojë programet trajnuese të Shoqatës;
 - (v) të mbajë dhe zhvillojë marrëdhëniet me donatorët ekzistues dhe të mundshëm;
 - (vi) të punojë me media që të sigurojë mbulimin e duhur të aktiviteteve të Shoqatës nëpër media;
 - (vii) të këshillojë, adoptojë dhe implementoj politikat e veprimit dhe aktivitetet e Shoqatës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave.
 - (viii) të implementoj rregulloret, aktet tjera normative, vendimet, dhe instrumentet tjera të adoptuara nga Kuvendi i Anëtarëve dhe Bordi i Shoqatës.
 - (ix) të implementoj buxhetin e Shoqatës.
 - (x) të ndërmarr të gjitha aktivitetet për t'i mbështetur në vazhdimësi Qëllimet dhe Objektivat e Shoqatës.

- 33.2 Struktura e Zyrës Ekzekutive do të definohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe do të aprovohet nga Bordi i Shoqatës.
- 33.3 Të punësuarit e Shoqatës, duke përfshirë këtu edhe Drejtorin Ekzekutiv, nuk mund të zgjedhen si anëtarë të Bordit të Shoqatës gjatë periudhës së punësimit në Shoqatë dhe 3 vite pas përfundimit të saj.
- 33.4 Asnjë person nuk do të zgjedhet si Drejtor Ekzekutiv, si dhe Drejtori Ekzekutiv i zgjedhur më herët do të largohet nga detyra për këto arsye:
- (i) humbjes së aftësisë së veprimit;
 - (ii) shpalljes fajtor për vepër penale në lidhje me ushtrimin e profesionit;
 - (iii) të qenit në gjini gjaku në vijë të drejtë në cilëndo shkallë dhe në vijë të tërthortë dhe gjini krushqie deri në shkallë të dytë me cilindo punonjës të Shoqatës;
 - (iv) rrezikim të interesave të Shoqatës duke vepruar në kundërshtim me vendimet e Kuvendit të Anëtarëve;
 - (v) arsye tjera të përcaktuara me Ligjin e punës për largimin e punonjësit nga puna.
- 33.5 Asnjë individ në gjini gjaku në vijë të drejtë në cilëndo shkallë dhe në vijë të tërthortë dhe gjini krushqie deri në shkallë të dytë me Drejtorin Ekzekutiv, nuk mund të ketë interes personal direkt apo indirekt në cilindo nga veprimet e Shoqatës.
- 33.6 Drejtori Ekzekutiv, me rastin e marrjes së detyrës, si dhe në secilin vit që pason, është i obliguar që të informojë Bordin e Shoqatës për çdo lloj interesi personal direkt apo indirekt, me të cilin ai apo anëtarët e familjes së tij kanë në lidhje me veprimet e Shoqatës.

Neni 34 **Komisioni për nominime**

- 34.1 Kuvendi i Anëtarëve do ta themelojë Komisionin për nominime dhe do të zgjedh anëtarët e tij. Komisioni për Nominime do të përbëhet nga 7 anëtarë:
- (i) Kryetari aktual i Bordit Shoqatës,
 - (ii) Dy ish Kryetarët e Bordit Shoqatës,
 - (iii) Katër ish anëtarë të Bordit të Shoqatës
- 34.2 Drejtori Ekzekutiv apo i deleguari i tij do të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit por pa të drejtë vote.
- 34.3 Komisioni për Nominime do ta këshilloj dhe do ti jap rekomandime Bordit të Shoqatës për:
- (i) Nominimin e anëtarëve për Bordin e Shoqatës,
 - (ii) Nominimin e anëtarëve për komisionet e themeluara nga Bordi Shoqatës apo Kuvendi i Anëtarëve
- 34.4 Anëtarët e Komisionit për Nominime do të zgjedhën për mandat 4 vjeçar me të drejtë të rizgjedhjes nga Kuvendi i Anëtarëve.
- 34.5 Anëtarët e Komisionit për Nominime gjatë mandatit të tyre në këtë Komision, nuk kanë të drejtë të kandidohen për pozitën e anëtarit të Bordit të Shoqatës, përveç nëse tërhiqen nga pozita e anëtarit të komisionit për nominime.
- 34.6 Arsyet e përfundimit të anëtarësisë para skadimit të mandatit, zëvendësimi i anëtarëve të Komisionit dhe çështje tjera rreth funksionimit të Komisionit për nominime do të përcaktohen me rregulloren e punës për Komisionin për nominime të miratuar nga Bordi i Shoqatës.

Pjesa 6
PROCEDURA DISIPLINORE NDAJ ANËTARËVE TË SHOQATËS

Neni 35
Përbërja e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë

- 35.1 Kuvendi i Anëtarëve do ta themeloj Komisionin për Sjellje dhe Disiplinë i cili do të zhvilloj procesin disiplinor ndaj anëtarët të Shoqatës dhe vendos për shkeljen disiplinore.
- 35.2 Komisioni për sjellje dhe disiplinë përbëhet nga pesë (5) anëtarë.
- 35.3 Kur një anëtar i komisionit jep dorëheqje, largohet apo vdes, ai/ajo do të zëvendësohet për mandatin e mbetur si anëtar i Komisionit nga anëtar i cili në takimin e fundit të Kuvendit të Anëtarëve ka qenë i nominuar për anëtar të Komisionit por numri i votave valide me emrin e tij/saj e ka vendosur atë në vendin e parë të listës së të nominuarve që nuk janë zgjedhur.
- 35.4 Anëtarët e komisionit disiplinor do të zgjedhën nga Kuvendi i Anëtarëve me mandat trevjeçar duke u bazuar në rekomandimet e Bordit të Shoqatës. Anëtarët e Bordit të Shoqatës nuk mund të zgjedhën anëtar të këtij Komisioni.
- 35.5 Anëtarët e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë gjatë mandatit të tyre në këtë Komision, nuk kanë të drejtë të kandidohen për pozitën e anëtarit të Bordit të Shoqatës, përveç nëse tërhiqen nga pozita e anëtarit të komisionit për Sjellje dhe Disiplinë.

Neni 36
Shkeljet disiplinore

- 36.1 Anëtar i Shoqatës do ti nënshtrohet procesit disiplinor, në këto raste:
- (i) Shkelja e standardeve profesionale dhe Kodit Etik gjatë ushtrimit të profesionit;
 - (ii) Sjellja e vetes apo profesionit në situatë të papërgjegjshme si pasoje e veprimit joprofesional;
 - (iii) Shkelja e dispozitave të Statutit, akteve tjera normative dhe vendimeve të Shoqatës;
 - (iv) Mos respektimi i kërkesave dhe dispozitave ligjore gjatë ushtrimit të profesionit;
 - (v) Shqiptimi i dënimit nga ndonjë gjykatë apo organ tjetër;
 - (vi) Shpifja ndaj shoqatës dhe anëtarëve të saj apo personelit të Zyrës Ekzekutive;
 - (vii) Përdorimi i paautorizuar i emrit dhe shenjave identifikuese të ShKÇAK;
 - (viii) Prezantimi i rrejshëm i thirrjes profesionale;
 - (ix) Ofrimi i paautorizuar i shërbimeve në emër të ShKÇAK;
 - (x) Ofrimi i dokumenteve dhe informacioneve të rrejshme lidhur me kërkesat e Shoqatës;
 - (xi) Kërcënimi apo kanosja ndaj anëtarit të shoqatës apo personelit të Zyrës Ekzekutive;
 - (xii) Shpalosja e paautorizuar e informatave konfidenciale të Shoqatës tek palët e treta
 - (xiii) Shkelja e rregullave të provimeve;
 - (xiv) Shqiptimi i masës disiplinore nga ndonjë trup tjetër profesional.

Neni 37
Procedura disiplinore

- 37.1 Bordi i Shoqatës do të miratojë Rregulloren për sjellje dhe disiplinë me të cilën do të rregullohen detajisht zhvillimi i procedurës disiplinore për shkelje disiplinore nga ana e anëtarit të Shoqatës.
- 37.2 Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë do të hulumtojë secilin rast në veçanti në pajtueshmëri me aktet normative të Shoqatës dhe Ligjin e aplikueshëm.

Neni 38
Masat disiplinore

- 38.1 Ndaj anëtarit të Shoqatës mund të shqiptohet këto masa disiplinore

- (i) vërejtje, ose
- (ii) suspendim, ose
- (iii) përfundim i anëtarësisë

Neni 39
E drejta në Ankesë

- 39.1 E drejta në ankesë në Panelin për ankesa të Shoqatës, ndaj vendimit të Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë është e drejtë e garantuar për çdo anëtar që i nënshtrohet procedurës disiplinore dhe / apo që i përfundon anëtarësia me largim apo përjashtim nën kushtet e përcaktuara me Statut.
- 39.2 Ankesa mund të ushtrohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit të Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë apo Njoftimit nga Zyra Ekzekutive apo Kuvendi i anëtarëve në rrethanat e përcaktuara me nenin 11.2 të Statutit
- 39.3 Paneli për ankesa do të marr Vendim lidhur me ankesën në afat prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të Ankesës.
- 39.4 Procedura ankimore pranë Panelit të Ankesave rregullohen me Rregulloren për Sjellje dhe Disiplinë.
- 39.5 Vendimet e Panelit të Ankesave janë përfundimtare.

Neni 40
Ankesat tjera

- 40.1 Anëtarët e Shoqatës kanë të drejtë në ushtrimin e ankesave për çështje administrative.
- 40.2 Ankesat do të adresohen në Zyrën Ekzekutive dhe varësisht nga natyra e çështjes, ankesat do të përcillen në departamentin përkatës për shqyrtim.
- 40.3 Përgjigja lidhur me ankesën anëtarit do t'i kthehet në afat prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të ankesës.
- 40.4 Nëse anëtari nuk është i kënaqur me përgjigjen e Zyrës Ekzekutive përkatësisht departamentit përkatës, ka të drejtë të ushtrojë ankesë tek Bordi i Shoqatës në afat prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimi të vendimit.
- 40.5 Bordi i Shoqatës vendos lidhur me ankesën në afat prej shtatë (7) ditësh. Vendimi i Bordit të Shoqatës lidhur me ankesën sipas këtij neni është përfundimtar.

Pjesa 7

RREGULLAT E MIRËSJELLJES PROFESIONALE

Neni 41

- 41.1 Shoqata si anëtare e FNK-së adopton si rregullativë të veten Kodin Etik të FNK-së dhe rregullativën tjetër përcjellëse të FNK- së lidhur me rregullat e mirësjelljes profesionale.
- 41.2 Versioni në gjuhën angleze i Rregullave të Mirësjelljes Profesionale do të mbizotëroj në çdo rast të konfliktit në interpretim të Kodit Etik të FNK në njërën anë dhe çdo dokumenti të përkthyer nga ShKÇAK dhe / apo akteve normative të miratuara nga ShKÇAK në anën tjetër.

Pjesa 8

PASURIA E SHOQATËS

Neni 42

Pasuritë

- 42.1 Pasuritë e Shoqatës përbëhen nga parat e gatshme, prona e tundshme, pasuritë e patundshme si dhe e drejta mbi pronën të cilën Shoqata e ka fituar duke u bazuar në ligjin e aplikueshëm dhe në këtë Statut.
- 42.2 Shoqata siguron të ardhurat nga:
- pagesat e anëtarësimit;
 - donacionet; dhe
 - aktivitetet e tjera ekonomike që shoqata mund t'i kryejë në pajtueshmëri me këtë Statut dhe ligjin e aplikueshëm.
- 42.3 Kuvendi i Anëtarëve do t'ia delegojë Bordit të Shoqatës përgjegjësinë për menaxhimin e pasurive të Shoqatës në pajtueshmëri me Qëllimet, Objektivat dhe Aktivitetet e Shoqatës dhe do të kërkojë nga Kryetari i Bordit të dorëzojë një raport vjetor për menaxhimin me këto pasuri gjatë vitit raportues.

Pjesa 9

SHPËRBËRJA E SHOQATËS

Neni 43

Shpërbërja e Shoqatës dhe shpërndarja e pasurisë së saj

- 43.1 Shoqata do të shpërbëhet me vendimin e dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Shoqatës.
- 43.2 Me shpërbërjen e saj, Kuvendi do të caktojë emrin e organizatës dhe/apo shoqatës në Republikën e Kosovës e cila do t'i marrë pasuritë e mbetura të Shoqatës pasi që të jenë paguar borxhet, shpenzimet e gjyqit dhe/apo shpenzimet e tjera procedurale.

Pjesa 10

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 44

Mandati i anëtarëve aktual të Bordit

- 44.1 Mandati i anëtarëve aktual të Bordit do të llogaritet sipas dispozitave të Statutit në fuqi në kohën e emërimit të tyre.

Pjesa 11

HYRJA NË FUQI

Neni 45

Hyrja në fuqi dhe ndryshimet e Statutit

- 45.1. Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Anëtarëve të Shoqatës.
- 45.2. Ky Statut mund të ndryshohet me votën e shumicës së anëtarëve që bëjnë kuorumin e Mbledhjes së Kuvendit të Anëtarëve.
- 45.3. Ky Statut në emër të Kuvendit të Anëtarëve nënshkruhet nga Përfaqësuesi i autorizuar i Shoqatës dhe Kryetari i Bordit.

Neni 46

Hyrja në fuqi e rregulloreve për të drejtat dhe obligimet e anëtarëve

- 46.1 Rregulloret dhe aktet tjera normative të miratuara nga Bordi i Shoqatës dhe vendimet e Shoqatës të cilat kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të Shoqatës do të publikohen në faqen zyrtare të Shoqatës dhe do të hyjnë në fuqi në afat prej 7 ditëve nga dita e publikimit.
- 46.2. Nëse çfarëdo dispozite e këtij Statuti apo interpretimet e mëparshme në Statut janë në konflikt me obligimet e theksuara ose të nënkuptuara nga DOA, do të mbizotërojnë kërkesat sipas DOA menjëherë pas publikimit të tyre në faqen zyrtare të SHKCAK

Data, 24.03.2025



Përfaqësuesi i autorizuar/Kryetari i Bordit
Adrian Alo

Adrian Alo